



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:107973

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597025

Ac.nr.1931/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit K.B. nga Gjakova, me vendqëndrim në I..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.B., avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, Lagja “...” nr..., Blloku ..., të cilën sipas autorizimit V.R., për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.61/19, datë 03.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.61/19 i datës 03.12.2019, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit jomaterial dhe për kompensimin e dëmit material dhe atë: për ushqimin e përforcuar, ndihmën e personit të tretë dhe shpenzimet e shërimit si dhe në pikën III për kamatën e gjykuar dhe në pikën IV, të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.
- II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.61/19 i datës 03.12.2019, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material për rehabilitim klimaterik dhe gjykohet si në vijim: “REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit K.B. nga Gjakova me vendqëndrim në Itali, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit

rrugor të datës 29.01.2017, në emër të rehabilitimit klimatik t'i paguaj shumën prej 1.000 €, me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim në afat mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data 03.12.2019 si ditë e vendimmarrjes e deri në pagesën definitive, në tërësi si e pabazuar”.

III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.61/19, të datës 03.12.2019, ka vendosur si në vijim:

PJESËRISHT aprovohet kërkesëpadia e paditësit K.B. nga Gjakova, me vendqëndrim në Itali, ashtu që:

- I. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “.....” me seli në Prishtinë, që në emër të zhdëmtimit të dëmit jomaterial dhe material, paditësit t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:
 - në emër të dëmit jomaterial:
 - për zhdëmtimin në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike shumën prej 3.000 €,
 - në emër të frikës shumën prej 2.000 €,
 - për zhdëmtimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 5.000€,
 - në emër të dëmit material:
 - për ndihmën e personit të tretë shumën prej 600€,
 - për ushqim të përforcuar shumën prej 100 €,
 - për shëmtim të lehtë trupor shumën prej 500 €,
 - për terapi fizikale shumën prej 1.000 € dhe
 - për shpenzimet e mjekimit shumën prej 967.15 €.
- II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit K.B. nga Gjakova, përtej shumës së gjykuar, për kompensimin e dëmit jomaterial dhe material dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1.500 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 11.000 €, për terapi fizikale shumën prej 2.000 €, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 900 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 1.400 € dhe për shëmtim të lehtë trupor shumën prej 500 € si e pabazuar.
- III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, që shumat e gjykuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'i paguaj me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim në afat mbi një vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga data 03.12.2019 si ditë e vendimmarrjes e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyruar.
- IV. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj edhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 2.810,04 €, e

të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit të detyruar.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe lënda t'i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje, ose të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të gjykohet në shumën e ofruar nga e paditura.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka kërkuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit K.B. dhe E.B. nga Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të tyre, me datë 28.02.2017, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtrësën e datës 18.09.2019, me të cilën ka kërkuar që të: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “...”, me seli në Prishtinë, që paditësve K.B. nga Gjakova dhe E.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës t’iu kompensoj: në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 15.000 €, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 4.500 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1.500 €, në emër të terapisë fizikale shumën prej 1.500 €, në emër të shëmtimit të lehtë trupor shumën prej 1.500 €, në emër të terapisë fizikale 1.500 €, në emër të frikës shumën prej 3.000 €. Në emër të paditësit E.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 12.000 €, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 4.000 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 1.500 €, në emër të ndihmës së huaj shumën prej 1.500 €, në emër të terapisë fizikale shumën prej 1.500 €, në emër të shëmtimit të lehtë trupor shumën prej 1.500 €, në emër të terapisë fizikale 1.500 €, në emër të frikës shumën prej 3.000 €, duke u detyruar e paditura që ti paguajë në emër të kamatë vonesës vjetore të shumës së gjykuar sipas normës prej 8 % për secilin paditës, duke filluar nga data e ushtrimit të padisë si dhe shpenzimet e procedurës e të gjitha këto kërkesa në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 03.12.2019, i autorizuari i paditësve ka konfirmuar se e tërheqë padinë në raport me paditësin E.B. nga fshati ..., Komuna e Pejës, pasi me të paditurën është arritur marrëveshje për kompensimin e dëmit nga aksidenti në trafik.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.61/19, të datës 03.12.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit K.B., duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me administrimin e provave ka vërtetuar se me datënrreth orësminuta, në fshatin ..., Komuna e Pejës, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, ku pjesëmarrës në këtë aksidenti ka qenë

drejtuesi i automjetit "...me targë të automjetit L.B. i cili qarkullonte në rrugën i cili me të arritur në fshatin në afërsi të pompës së derivateve "....", gjatë tejkalimit kalon në shiritin e kundërt dhe shkakton aksident, me ç 'rast paditësi merr lëndime trupore, duke përjetuar kështu dhimbje fizike dhe frikë, por edhe dëme materiale. Gjykata ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqëse është jo kontestuese baza juridike, për çka palës paditëse në kërkesë të paditurës e ka siguruar provën - aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 491/17 i datës 31.05.2017 për shpalljen përgjegjës të drejtuesit të automjetit të siguruar te e paditura.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. Enver Muja ortoped - traumatolog dhe Dr. Muhamet Halitaj psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.05.2018, kanë konstatuar se paditësi, si pasojë e këtij aksidenti ka pësuar këto lëndime trupore: thyerje e kockës së ullnës së majtë, thyerje e pjesës distale të radiusit në parallërën e djathtë si dhe frakturë e majtë e patellës në gjurin e djathtë, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuar, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, e cila ka zgjatur 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 1 orë, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 10 ditë dhe dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka ende edhe sot e kësaj dite. Ndihma dhe kujdesi i personit të tretë ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 muaj. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Terapia fizikale ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 10 ditësh. Shëmtimi trupor ka qenë i shkallës së lehtë në dorën e majtë ku i është vërejtur cikatriksa nga operimi. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor ka qenë i shprehur në shkallën prej 15 %, Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondash, frikë sekondare me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej 3 orë, të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 muaj dhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka zgjatur 8 muaj.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata i është referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa për lartësinë e shpenzimeve ka vendosur duke iu referuar tarifës për përfaqësimin e dy paditësve, meqë në marrëveshjen e arritur jashtëgjyqësore për paditësin E.B., palët janë dakorduar që për shpenzime të vendoset nga gjykata sipas dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesës së kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar apo jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i

komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë ...rreth orës minuta, në rrugën me të arritur në fshatin përkatësisht afër pompës së derivateve “.....”. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguarur te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit “...”, me targa të regjistrimit, ngjyrë e ..., të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte L.B. nga fshati, Komuna e Pejës, ndërsa paditësi ka qenë në cilësinë e bashkudhëtarit, pra nuk ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët - këtu e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit - përgjegjësinë e siguruarit të saj, siç është deklaruar përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10.05.2018, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se paditësi ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë, drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”. Në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.09.2019 paditësit i ka ofruar ofertë në lartësi prej 6.000 €, të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me kërkesëpadinë sa i përket dëmit jomaterial për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këto kategori të dëmit në atë mënyrë që shumica e gjykuar është në ekuivalencë më të mirën e shkelur, duke siguarur që kompensimi të shërbej si satisfakcion për paditësin. Gjykata drejtë ka vlerësuar dhe vendosur sa i përket këtyre kategorive të dëmit jomaterial sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor të cilët kanë konstatuar se paditësi ka përjetuar dhimbje fizike dhe frikë të konstatuara si më lartë, po ashtu kanë konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 15 %, shëmtim trupor - shkalla e ultë e shëmtimit, e rrjedhimisht edhe me rrethanat tjera të cilat i ka marrë në konsideratë gjykata e të cilat ndikojnë në përcaktimin e lartësisë, siç është në këtë rast natyra dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shkallën e shëmtimit trupor si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e këtij lloji të dëmit material, për ushqimin e përforcuar dhe për ndihmën dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 2 muaj dhe ushqimi të përforcuar ka pasur nevojë në kohëzgjatje prej 10 ditë. të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve i njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar, prandaj gjykata ankimore vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën e vërtetuar të aktgjykimit përkitazi me dëmin material për shpenzimet e shërimit, Gjykata e Apelit vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sepse baza juridike për këto kategori të dëmit gjen mbështetje në nenin 179 të LMD-së. Në këtë rast palës paditëse si pasojë e aksidentit i janë shkaktuar shpenzime të mjekimit dhe shpenzime tjera, e lartësia e tyre është vërtetuar me prova dhe atë: faturat dhe kuponët fiskal prezent në shkresat e lëndës, të cilat janë administruar si prova materiale nga gjykata e shkallës së parë.

Aktgjykimi nga gjykata e shkallës së dytë është ndryshuar dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpenzimeve për rehabilitimin klimatik, për arsye se paditësi nuk ka ofruar prova që vërtetojnë këtë kategori të dëmit material, e që ka qenë i obliguar për një gjë të tillë, në kuptim të dispozitave të nenit 7 dhe 319 të LPK.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata e Apelit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës konstaton se gjykata e shkallës së parë me rastin e përpilimit të aktgjykimit të atakuar, në pikën I, të dispozitivit, ku është shkruar në emër të dëmit material: për shëmtimin e lehtë trupor, në fakt duhet të ishte shkruar në emër të dëmit jomaterial, pasi që shëmtimi trupor është kategori e veçantë e cila bënë pjesë në dëmin jomaterial. Kjo gjykatë ka vlerësuar se ky kategorizim është gabim teknik në të shkruar dhe si i tillë nuk ka asnjë ndikim në mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë dhe si i tillë nëse paraqet pengesa për përmbarrim në të ardhmen.

Numri i lëndës: 2019:107973
Datë: 19.04.2024
Numri i dokumentit: 05597025

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragraf 1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1931/20, me datë 04.04.2024

Kryetare e kolegjit
Hunaida Pasuli